



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:059896
Datë: 23.01.2025
Numri i dokumentit: 06745853

P.nr.155/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM- Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit V.M nga Peja, i akuzuar për veprën penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjë PP/II.nr.245/2024, të datës 20.02.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar publik të datës 14.01.2025, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit V.M, me datën 17.01.2025, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

V.M, i lindur më datë në, me vendbanim në fshatin në Komuna e Pejës, nga babai A. dhe nëna A2. e gjinisëBerisha, i divorcuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal të letërnjoftimit, me nr. të tel., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me dt. 06.10.2023, rreth orës 18:20, në rr.magjistrale Pejë – Gjakovë pa autorizim posedon narkotik substanca psikotrope ose analoge të shpallura të rrezikshme në kundërshtim me nenin 9 dhe nenin 14 të Ligjit për barnat narkotike substanca psikotrope dhe prekusore nr.02/L-128 dhe atë të llojit heroinë, në atë mënyrë që gjatë ndalimit dhe kontrollit nga patrulla e Policisë Stacionit Policor në Pejë të angazhuar sipas planit operativ në autobusin të kompanisë “Besarti Tours”, që ka lëvizur në linjën Pejë – Llugaxhi, në të cilin i pandehuri ishte pasagjer, pikërisht në ulësen ku ishte ulur i pandehuri, janë gjetur dy qese të mbushura me pluhur ngjyrë kafe e mbyllët e dyshuar substancë narkotike të llojit heroinë, ku nga ekzaminimi laboratorik në DHTN në Pejë të pranuar me datë 30.10.2023 është konstatuar se D #1 dhe D#2, kishte në posedim 0.93 gram, substancë narkotike të llojit heroinë,

- Me çka ka kryer veprën penale "*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*" nga neni 269 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71, 72 dhe 269 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

- I. Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej tetëqind (800) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet të e paguaj në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Si dhe me **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej tetë (8) muajsh, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit prej një (1) viti, nëse nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën të cekur si më lartë brenda afatit të lartcekur, gjykata konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do të e zëvendësoj dënimin me gjobë në dënim me burgim, ku njëzetë (20) euro, gjobë llogaritet barabartë me një (1) ditë burgim. Nëse i pandehuri e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.
- IV. Nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit të përcaktuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kryen vepër tjetër penale, dënimi i kushtëzuar në kohëzgjatje prej tetë (8) muajsh, do të revokohet dhe do të ekzekutohet dënimi me burgim.
- V. **OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej njëzetë (20) euro, e të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- VI. Konform nenit 269 par.3 të KPRK-së, **KONFISKOHET** - substanca narkotike e llojit heroinë, në peshën neto 0.93 gram të sekuestruara përkohësisht, dhe urdhërohet Policia e Kosovës që të bëj shkatërrimin e substancës narkotike të llojit heroinë, të sekuestruar sipas vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, të datës 06.10.2023, me nr. të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.245/2024, të datës 20.02.2024, ndaj të pandehurit V.M, për shkak të veprës penale "*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*" nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datë 14.01.2025, ka mbajtur seancën fillestare në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit V.M.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit PP/II.nr.245/2024, të datës 20.02.2024, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën dhe tutje ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe pasi që i pandehuri V.M, ka deklaruar që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë me ç'rast i njëjti në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije të plotë ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, dhe se ndihet i penduar dhe premtan se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra të tjera penale.

Andaj, gjykata ka marrë mendimin e palëve në procedurë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, me ç'rast Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti se në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin se gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i policit A. H. #6596 me nr. R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78 i dt. 06.10.2023, Raporti i oficerit K.S. #11165, Raporti i oficerit A.S. #11423, Raporti i oficerit Sh.G. #11417, Raporti fillestar i incidentit me nr. te rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78 i dt. 06.10.2022, Raporti i analizës së narkotikëve nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Narkotik – Pejë me nr. R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78 i dt. 06.10.2023, Fotografitë e dëshmisë D#1, D#1.1 dhe D# 1.2, i analizës dhe matjes së substancës narkotike, Vërtetim mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve me nr. R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78 i dt. 06.10.2023, Deklarata e të pandehurit V. M. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 06.10.2023, Deklarata e dëshmitarit R.A. e dhënë në Stacionin Policor në Pejë me dt. 06.10.2023, Njësia e Forenzikës i dt. 23.01.2024, po ashtu, gjykata ka gjetur se aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurori i Shtetit Ermal Demhasaj, lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese, ka deklaruar se: *Në kuptim të rrethanave rënduese i propozoj gjykatës që te marr parasysh dënimet e mëparshme ndaj të pandehurit ndërsa si rrethane lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I pandehuri V.M, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale që e kam kryer, nuk jam duke përdoruar me substanca narkotike, i premtoj gjykatës që brenda territorit të Kosovës nuk do të përdori substanca narkotike.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge*” nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprat e kryera penale dhe gjykata e ka vërtetuar se e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me vendimin mbi dënim konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese për të pandehurin gjeti se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimet e tij, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, ndërkaq gjykata rrethana rënduese për të pandehurin gjeti se i pandehuri ka qenë i dënuar edhe më herët dhe atë me Aktgjykimin e formës së prerë P.nr. 396/2022 nga Gjkata Themelore në Pejë, i plotfuqishëm me datën 13.11.2024, i dënuar me Dënim me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, si dhe me dënim me gjobë treqind (300) euro, për shkak të veprës penale “*Mashtrimi*” nga neni 323 par.1 i KPRK-së, si dhe me Aktgjykimin e formës së Prerë P.nr.858/2013 të Gjykatës Themelore në Pejë, i plotfuqishëm me datën 27.04.2020, i dënuar me dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro, për shkak të veprës penale, “*Vjedhje*” nga neni 252 par.1 KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë së tij penale dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit me kusht u mor në përputhje me nenin 48 par.1 dhe 2, e lidhur me nenin 49 par.1, dhe par.4 të KPRK-së, e po ashtu me nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas të cilit është parashikuar se formën themelore të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen: “*Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substancave psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri*

në tre (3) vjet”, ndërkaq ku në dispozitën par.1 të nenit 49, që i referohet kushteve mbi shqiptimit e dënimit me kusht përcaktohet se: “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, ndërkaq në par.4 përcaktohet se: “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”. Ndërkaq sipas par.5 të nenit 49 të KPRK-së, i cili përcakton se: “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”, gjykata ka shqiptuar dënim me kusht vetëm sa i përket dënimit me burgim. Tërheqja e vërejtjes të pandehurit se nëse në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti do të kryej vepër tjetër penale ndaj tij do të ekzekutohet dënimi me burgim si në dispozitivin e këtij aktgjykimit, është një paralajmërim serioz që i njëjtit të parandalohet në kryerjen e veprave penale në të ardhmen.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi nëse i pandehuri dështon, refuzon apo nuk dëshiron ta paguaj dënimin e shqiptuar me gjobë është marrë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Vendimi për revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit kryen vepër tjetër penale, është marrë konform nenit 50 par.2 të KPRK-së, andaj ka vendosur si në pikën e IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi si në pikën e V të dispozitivit të këtij aktgjykimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 449 par.1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe nën par. 2.6, të KPPRK-së, ndërsa konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimin, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin si në pikën VI të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori duke u bazuar në dispozitat e nenit 269 par. 1 të KPPRK-së, lidhur me nenin 269 par. 3 të KPRK-së, me ç’rast substanca narkotike e llojit heroinë, me peshë 0.93 gram, e sekuestruar në bazë të vërtetimit mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i datës 06.10.2023, me nr. të rastit R-2023-XI-DKKO-HTN-PE-78, është konfiskuar dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, është urdhëruar shkatërrimi i saj sipas procedurave standarde ligjore.

Nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 364 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL
P.nr.155/24, me datë 23.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtarja e vetme gjyquese

Leonita Lajçi Muçaj

Blerta KELMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.